



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në bazë të nenit 17 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe ansferte, nr. 01/111-400 të datës 28 maj 2012 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, si dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore 2021-2020, nr. 01-400/-03-0075925/19, datë 23.09. 2019, bën:

F T E S Ë P U B L I K E

Për aplikim në projektin:

➤ **LINJË (Mullinjë) PËR PRODHIM TË USHQIMIT TË KAFSHËVE**

Projekti do të realizohet në bashkëfinancim me përfituesit.

Në kuadër të projektit përfshihen fermerët të cilët posedojnë;

- 7 e më shumë krerë të gjedheve - (30 fermer përfitues)
- 50 e më shumë krerë të deleve dhe dhive - (10 fermer përfitues)
- 3000 e më shumë shpezë (pula vojse) - (10 fermer përfitues)

Subvencionimi në projektin e cekur realizohet përmes formës së participimit financiar nga ana e fermerëve përfitues. Fermerët përfitues do të marrin pjesë me **30%** të vlerës së projektit.

Komuna në cilësinë e subvencionuesit do të marrë pjesë me **70%** të vlerës së projektit.

Fermerët përfitues para lidhjes së kontratës do të paguajnë **30%** të vlerës së kontratës në llogarinë bankare të Komunës.

Përfitues : Pesdhjete (50) fermer

KUSHTET PËR APLIKIM

- Të jetë banor i Komunës së Podujevës (kopja e letërnjoftimit)
- Vërtetimi i tatimit në pronë
- Vërtetimi nga AVUK për numrin e krerëve të kafshëve/shpezëve (gjedhët, delet, dhitë dhe pulat)

- Afati i aplikimit: nga data 29.06.2020 deri me 15.07.2020

- Aplikacionet dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë, objekti i ri I Komunës, kati përdhësë, në sportel.

Nr. prot. 12-320/04-0032122/20
Podujevë, _____

